

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

REHABILITIM I SINJALISTIKES SE QYTETIT

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV 349221007-7 – Vijezieme te rrugëve, 34992200-9 – Sinjalistike rrugore

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,329,055 (tete milion e treqind e njezet e nente mije e pesedhete e pese) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojces nr.8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së parshikuar të kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i

bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43 pka 2/c të VKM nr.285 datë 19.05.2021 ku citohet ” 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021 dhe 2022 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor vetem nga operatori I shpallur fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve "a" ose "b" e bën ofertën të kualifikueshme

Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë. Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55 pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Percaktimi i vlerës se kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55 pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive:

-NP-12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

-NS-6/ A (Sinjalistika rrugore jondriçuese)

-NS-18/A (Punime topogjeodezike)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë

16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NP 12/A- Punime të inxhinierise së mjedisit. Punime pastrim asfalti dhe reaksionet kimike të bojërave Referuar preventiv.

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

NS 6 – Punimet sinjalistike rrugore jondriçuese. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare. Referuar preventiv.

Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e madhe se 20 milion leke.

NS 18 - Punime topogjeodezike. Punime për piktimin e tabelave dhe vijezimit. Referuar preventiv.

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. 1 (nje) Inxhinier Ndertimit, të Profilit Infrastruktura të Transportit.
1 (një) Inxhinier Mjedisi
1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder
2. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat përkatëse E-Sig për të paktën **3(tre) muajt e fundit** si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV.
3. Vetdeklarimin nga **inxhinieri ndertimit**, **topograf** dhe **mjedisit** se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 të kriterëve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është

përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt, me profesion inxhinier ndertimi** i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtnuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunitimit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c". Referuar rekomandimit të app nr. 6732 prot date 21.10.2020,

2.3.5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, **Diplome/certifikate**, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **3(tre) muajt e fundit**. *(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomikë, secili prej Operatoreve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*
- b) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, **Diplome/certifikate**, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **3(tre) muajt e fundit**. *(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomikë, secili prej Operatoreve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*
- c) 1 (një) punonjës që disponon Diplome/certifikate si "**Auditues / Inspektues i Sigurisë Rrugore (Auditin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin e pikave të zeza)**" lëshuar nga Institucionet Kompetente Shtetërore në përputhje me klauzolat e Direktivës 2008/96/EC ose ekuivalente me të, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, **Diplome/certifikate** si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **3(tre) muajt e fundit**.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për 1 (nje) Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen te cilat mund të jenë potencial të shkaktojnë aksidenteve në rrugë ose me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe dhenien e ndihmes se pare në raste aksidentesh/Zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjesi të pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”

- 2.3.6.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve duke përfshirë edhe stafin teknik të siguruar për 3(tre) muajt e fundit duhet të jetë **25 (njetë e pesë)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisllacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre“.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (bojra, adeziv). Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e

testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose vertetimit ose dokumentit ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertohen, është kërkesë e ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, duke ofruar dhe garanci për mallrat që do të furnizohen.

2.3.8 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë:

Mjetet	Sasia
Makineri vijëzimi me bojë Bikomponente me kapacitet minimumi 400 liter	1 copë
Set Semaforësh për kontrollin e trafikut	1 copë
Mjet fshese për pastrimin e asfaltit	1 copë
Kamionçinë jo me pak se 1,5 – ton	1 copë
Kamion me vinç të integruar	1 copë
Kompresor (i lëvizshëm)	1 copë
Gjenerator	1 copë
Karrel për sinjalizimin e punimeve në rrugë	1 copë

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati dhe objekti i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera që shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- v. Për mjetet makineri vijezimi termoplastik ne lejen e qarkullimit te tyre duhet te jete e cilesuar si APV (automjet i perdorimit te veçante).
- vi. Operatori ekonomik për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

2.3.9 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.
3. ISO 45001(Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe shëndetit të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates).